

Kurrikula per parashkollorin (Lpfo 98)

Rreth kurrikules per parashkollorin

Urdherese per kurrikulen e parashkollorit

1. Vlera dhe detyra themelore per parashkollorin
2. Objektiva dhe udhezime
 - 2.1 Norma dhe vlera
 - 2.2 Zhvillimi dhe te mesuarit
 - 2.3 Influenca e femijes
 - 2.4 Parashkollori dhe familja
 - 2.5 Bashkepunimi midis klases parashkollore, shkolles dhe qendres per kalimin e kohes se lire

Ky publikim mund te porositet nga:
Fritzes kundservice
SE-106 47 Stokholm
Telephone: +46.8.690 91 90
Telefax: + 46.8.690 91 91
E-mail: order.fritzes@liber.se
Internet: ccc.fritzes.se

Kurrikulum per parashkollorin, Lpfo 98
ISBN 91-38-31790-7
Ministria e Arsimit dhe Shkences ne Suedi dhe
Agjensia Kombetare per Arsimin
Artikulli no. U98.019
Perkthim: Brian R. Turner
Perkthim: Graphium Vastra Aros 2001

RRETH KURRIKULES PER PARASHKOLLORIN

Kjo eshte kurrikula per parashkollorin, qe nenkupton se parashkollori do te perbeje hapin e pare ne sistemin arsimor per femije dhe te rinj. Qe nga 1 Janari 1998, Agjensia Kombetare per Arsimin ka luajtur rol si autoritet supervizues per parashkollorin ashtu si dhe per aktivitete te tjera parashkollore dhe femije te moshes shkollore. Legjislacioni u persfshi ne Aktin Arsimor ne te njejten date.

Kurrikula bazohet ne nje ndarje te pergjegjesise ku shteti percakton objektivat e pergjithshem dhe udhezime per parashkollorin dhe ku bashkete kane pergjegjesi te plote per zbatim. Ne strukturen e saj kurrikula e parashkollorit perputhet me kurrikula te tjera te sistemit arsimor. Si rezultat i prezantimit te kurrikules per parashkollorin, sistemi arsimor perfshin ne pergjithesi tre kurrikula, e para, per parashkollorin (Lpfo 98), e dyta, per sistemin shkolor te detyruar duke perfshire gjithashtu edhe klasat parashkollore dhe qendrat per kalimin e kohes te lire. (Lpf 94). Synimi eshte qe tre kurrikulat duhet te lidhen me njera tjetren dhe te japin dije te perbashketa mbi zhvillimin dhe te mesuarin.

KURRIKULA ZBATOHEK NE PARASHKOLLORIN

Kjo kurrikul zbatohet ne parashkollorin, d.m.th. ne aktivitetet pedagogjike per femije ne parashkollorin per te cilat bashkete jane te pergjegjshme. Kurrikula do te siguroje gjithashtu nje baze per vleresimin e kerkesave te cilesise duke percaktuar ne se nje individ parashkollor permush kerkesat e parashikuara. Kurrikula do te zbatohet gjithashtu ne shtepite me perkujdesje familjare.

Kurrikula per parashkollorin zevendeson programin pedagogjik dhe udhezimet e nxjerra nga Bordi Kombetar i Shendetit dhe Mireqenies, qe perdoreshin me pare per drejtimin e ketyre veprimtarive. Kurrikula eshte nje rregull qe percakton kushte te nxjerra nga Qeveria. Kurrikula do te drejtoje parashkollorin dhe permban kerkesat qe shteti imponon per parashkollorin. Ajo shpreh gjithashtu kerkesa dhe parashikime qe prinderit dhe femijet kane per parashkollorin.

Kurrikula percakton vlera themelore per parashkollorin, per detyrat, objektivat dhe udhezimet per aktivitete parashkollore. Sidoqofte, kurrikula nuk percakton mjetet me te cilat do te arrihen keto synime. Kjo eshte nje ceshtje se pari per stafin qe punon ne ciklin parashkollor. Organizatori kryesor eshte i pergjegjshem per te siguruar qe institucioni parashkollor te jete ne pozicionin e duhur per te arritur objektivat e kurrikules. Zhvillimi dhe te mesuarit per femijen si individ do te mbeshtetet ne lidhjen e ngushte midis parashkollorit dhe familjes.

STRUKTURA E KURRIKULES

Seksioni prezantues i kurrikules trajton vlerat dhe detyrat themelore te parashkollorit. Synimet dhe udhezimet per parashkollorin qe vijojne me poshte duhet te kuptohen ne kete plan.

Objektivat dhe udhezimet per parashkollorin jepen per fushat e meposhteme:

- Normat dhe vlerat
- Zhvillimi dhe te mesuarit
- Influenca e femijes
- Parashkollori dhe femija
- Bashkepunimi midis klases parashkollore, shkolles dhe qendres per kalimin e kohes se lire.

Synimet percaktojne drejtime te punes per parashkollorin dhe permbajne objektiva per zhvillimin e cilesise ne ciklin parashkollor. Objektivat ne kurrikulen e parashkollorit duhet te synojne tek zhvillimi individual dhe te mesuarit nga femija. Vazhdimesia midis kurrikulave do te jete e lehte per t'u vendosur, si rezultat i percaktimit te synimeve te perbashketa si per parashkollorin ashtu edhe per shkollen.

Ne ciklin parashkollor rezultatet e femijes si individ nuk do te percaktohen formalisht me noten dhe vleresimin. Parashkollori siguron veprimtari pedagogjike ne te cilen femijet mund te perfshihen ne moshat te ndryshme dhe ne periudha te ndryshme kohe. Parashkollori duhet te jete i sigurt, ne zhvillim dhe i pasur ne mundesi te mesuarit qe ofron per te gjitha femijet e perfshire, ne baze te kushteve individuale per çdo femije.

Udhezimet ne kurrikul percaktojne se veprimtaria e orientuar me objektiva per parashkollorin do te zbatohet nga vete ekipi kryesor pergjegjes per veprimtarine dhe nga te gjitha ata qe punojne ne nivelin parashkollor. Ekipi pergjegjes i referohet stafit qe ka pergjegjesi pedagogjike per nje grup te caktuar femijesh.

Planifikimi, zbatimi, vleresimi dhe zhvillimi

Aktivitetet e parashkollorit duhet te planifikohen, zbatohen, vleresohen dhe zhvillohen ne perputhje me objektivat e pecaktuara ne kurrikul. Eshte e rëndësishme qe metodat e vleresimit te jene te lidhura qarte me objektivat e pecaktuara per aktivitetet dhe qe ato te kontribuojne ne zhvillimin e pergjithshem te veprimtarise pedagogjike. Nepermjet dokumentimit te veprimtarise pedagogjike, veprimtarite ne ciklin parashkollor mund te behen me te qarta dhe ne kete menyre te sigurojne nje baze te rëndësishme per vleresimin e cilesise se veprimtarive dhe nevojave per zhvillim.

Arritja e objektivave te kurrikules kerkon staf te arsimuar, qe te jene te pajisur me mundesi per te gjalleruar aftesite e tyre dhe per te patur mbeshtetjen qe atyre u nevojitet per te plotesuar detyrat ne menyre profesionale. Plotesimi i detyrave ne ciklin parashkollor imponon gjithashtu kerkesa te larta per drejtimin. Bashkite ne kapacitetin e tyre si organizues kryesore jane te pergjegjshem per kete gje.

Kurrikula mbeshtetet ne Aktin Arsimor

Kapitulli 2 a, paragrafi 1-12 ne Aktin Arsimor (1985: 1100) permban kushtet kryesore per menyren si do te organizohen veprimtarite parashkollore. Akti percakton se bashkite jane te detyruara te sigurojne veprimtari parashkollore te nje cilesie te larte dhe pa zvarritje e vonesa te pajustificuara. Ky detyrim perfshin te gjithe femijet prinderit e te cileve jane ne marredhenie pune apo studimi, ose ata qe kane nevoje mbeshtetje per perkujdesjeje per femijen, ashtu si dhe per te gjithe femijet ne nevoje per mbeshtetje te vecante. Detyra e parashkollorit eshte te organizoje dhe te zhvilloje veprimtari pedagogjike. Stafi duhet te jete me arsimimin dhe eksperiencen e nevojshme, i afte per te permbushur nevojat e femijes per perkujdesje dhe veprimtari pedagogjike cilesore. Madhesia dhe perberja e grupeve te femijeve duhet te jete ne masen e duhur. Kushtet duhet te jene te pershtatshme per qellimin e tyre. Femijet qe kane nevoje per mbeshtetje te vecante per zhvillimin e tyre duhet te marrin perkujdesje qe lidhet me nevojat e tyre.

Urdherese per kurrikulen e parashkollorit

1996-06-11

Qeveria dekreton sa me poshte vijon:

Kurrikula sikurse paraqitet ne apendiksin e kesaj urdherese do te zbatohet ne ciklin parashkollor.

Kjo urdherese do te shpallet ne kodin e statutit (SKOLFS) te Agjensise Kombetare per Arsimin.

Kjo urdherese hyn ne fuqi ne 1 Gusht 1998.

Per dhe ne emer te Qeverise,

YLVA JOHANSSON

Barabara Martin Korpi
(Ministria e Arsimit dhe Shkences)

1. Vlera dhe detyra themelore per parashkollorin

Vlera themelore

Demokracia formon themelin e parashkollorit. Per kete arsye gjithe aktiviteti parashkollor duhet te kryhet ne perputhje me vlerat themelore te demokracise. Çdonjeri dhe dhe kushdo qe punon ne ciklin parashkollor duhet te nxite respekt per vlerat thelbesore te çdo personi ashtu si dhe respekt per mjedisin tone te perbashket.

Nje detyre e rëndesishme e parashkollorit eshte te krijojë dhe ndihmojë femijet te përvetësojnë vlerat mbi te cilat mbështetet shoqëria. Pacenueshmeria e jetes njezore, lirise individuale dhe integritetit, vlerat e barabarta per te gjithë njezitet, barazia midis gjinive ashtu si edhe solidariteti me shtresat e pambrojtura dhe te paperkrahura te shoqërisë janë te gjitha vlera qe shkolla duhet te nxite ne menyre aktive ne punen e saj me femijet.

Themeli mbi te cilat qendrojnë keto vlera shpreh qendrimin etik qe duhet te karakterizojë te gjithë veprimtarine parashkollore. Kujdesi dhe konsiderata ndaj personave te tjere ashtu si edhe drejtësia dhe barazia, krahas te drejtave te çdo individi, do te theksohen dhe do te behen te qarta ne te gjithë veprimtarine parashkollore. Femijet asimilojnë vlerat etike dhe normat kryesisht permes eksperiencave te tyre konkrete. Qendrimet e te rriturve ndikojne qe femijet te kuptojne dhe respektojne te drejtat dhe detyrimet qe zbatohen ne nje shoqëri demokratike. Per kete arsye te rriturit luajne nje rol te rëndesishem si modele.

Vleresimi i ketyre vlerave kryesore kerkon qe qendrimet nga te cilat ato burojnë te jene te shprehura qarte ne veprimtarine e perditeshme. Aktivitetet e parashkollorit duhet te kryhen ne menyre demokratike dhe te sigurojnë ne kete menyre themelin per rritjen e pergjegjesisie dhe interesit nga ana e femijeve per pjesmarrje aktive ne shoqëri.

Te kuptuarit dhe kujdesi per te tjeret

Parashkollori duhet te marre parasysh dhe te zhvillojë aftësi e femijeve per te marre pergjegjesi dhe per te menaxhuar jeten e tyre shoqërore ne menyre qe solidariteti dhe toleranca te vendosen qe ne moshe te vogel.

Parashkollori duhet te nxite dhe forcojë perkujdesjen dhe dashurine per te tjeret. Te gjitha veprimtarite duhet te karakterizohen nga dashuria per individin dhe synimet per te zhvilluar ndjenjen e dashurise dhe konsiderates per te tjeret, ashtu si edhe qendrimin te hapur dhe respektit per ndyshimet qe njezitet kane ne menyren si ata mendojnë dhe jetojnë. Mbështetje duhet t'i jepet gjithashtu nevojave te femijes per te qene i afte per te reflektuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre per çështje qe ofron jeta.

Rritja e levizjeve midis kufijve kombetare krijon diversitet ne kultura ne ciklin parashkollor, te cilat u japin mundësi femijeve te tregojne respekt dhe konsiderate per çdo individ pavaresisht nga prejardhja.

Objektivitet dhe pergjithesime

Parashkollori duhet te jete i hapur ndaj ideve te ndryshme dhe te nxite shprehjen e tyre. Femijeve duhet t'u jepet mundesia te formojne opinionet e tyre dhe te bejne zgjedhje ne driten e rrethanave te tyre personale. Ne kete menyre do te krijohet dhe rritet pjesmarrja dhe besimi i tyre i plote ne aftesite e tyre. Te gjitha prinderit duhet te jene ne gjendje te dergojne femijet e tyre ne ciklin parashkollor, me besim te plote se femijet e tyre nuk do te paragjykoen per shkak te çfaredolloj pikpamje te veçante.

Te gjitha qe punojne ne ciklin parashkollor duhet te miratojne dhe mbeshtetin vlerat themelore qe jane percaktuar ne kete kurrikul dhe duhet te shkeputin veten ne menyre te qarte nga çdo gje qe eshte ne konflikt me keto vlera.

Menyrat sipas se cilave te rriturit pergjigjen ndaj djemve dhe vajzave, ashtu si edhe kerkesat qe ju imponohen femijeve, kontribuojne ne pranimin prej tyre te ndryshimeve gjinore. Parashkollori duhet te punoje per te kundershtruar modele dhe role gjinore tradicionale. Vajzat dhe djemte ne ciklin parashkollor duhet te kene te njejtat mundesi per te zhvilluar dhe eksploruar aftesite dhe interesin e tyre pa patur kufizime te imponuara nga role gjinore steriotipe.

Parashkollori duhet, pavaresisht nga ku e ka vendndodhjen, te punoje me qellim qe te arrije objektivat e veprimtarise pedagogjike. Kujdesi per mireqenien individuale te femijes, per sigurine, zhvillimin dhe te mesuarin, duhet te karakterizojne veprimtarine e parashkollorit. Duhet te kihet parasysh kushtet e ndryshme dhe nevojat e femijeve. Kjo do te thote qe parashkollori nuk mund te organizohet kudo ne te njejten menyre, dhe se burimet e parashkollorit nuk duhet te shperndahen njelloj.

Detyrat e parashkollorit

Parashkollori duhet te hedhe themelet per te mesuarit gjate gjitha jetes. Parashkollori duhet te jete i pelqyeshem, i sigurt, dhe i pasur ne forma te mesuari per te gjitha femijet. Parashkollori duhet ti pajise femijet me veprimtari cilesore pedagogjike, ku kujdesi, rritja/edukimi dhe te mesuarit formojne nje koherence/lidhje teresore. Ne bashkepunim me familjen, duhet te nxitet zhvillimi i femijeve ne persona dhe antare te pergjegjshem te shoqerise.

Parashkollori duhet te ndihmoje familjet duke i mbeshtetur ato ne rolin e tyre per te rritur dhe per te ndihmuar femijet e tyre te rriten dhe zhvillohen. Detyra e parashkollorit nenkupton te punohet ne bashkepunim me prinderit, ne menyre qe femijeve t'u jepet mundesia per t'u zhvilluar ne perputhje me potencialin e tyre.

Veprimtarite pedagogjike duhet te lidhen me nevojat e te gjitha femijeve ne parashkollorin. Femijet qe zakonisht apo baza me permanente kane nevojte per me shume mbeshtetje se te tjeret duhet ta kene kete mbeshtetje ne lidhje me nevojat dhe kushtet e tyre. Aftesia e stafit ne te kuptuarin e femijeve dhe bashkeveprimin me femijet dhe fitimi i besimit te prinderve jane te rendesishme, neqoftese periudha ne ciklin parashkollor duhet te siguroje mbeshtetje per femijet qe perballen me veshtiresi.

Te gjitha femijet duhet te jene te afte te perjetojne kenaqesine qe vjen nga ecja perpara (progresi), kapercimi i veshtiresive dhe ndjenja e te qenit antare te vleresuar te grupit.

Parashkollori duhet të marrë parasysh faktin që femijet kanë kushte dhe mjedise të ndryshme jetese dhe se ata përpiqen të krijojnë kontekst dhe të nxjerrin kuptim nga eksperiencat e tyre. Të rriturit duhet t'u japin mbështetje femijeve në zhvillimin e besimit dhe vet-besimit. Duhet të nxitet kurioziteti i femijes, ambicjet dhe interesat dhe të stimulohet dëshira e tyre për të mesuar. Detyra e parashkollorit përfshin jo vetëm zhvillimin e aftësive dhe krijimtarinë kulturore të femijes por edhe kalimin e trashëgimnise kulturore – vlerat e saj, traditat, historia, gjuha dhe dijet – nga njeri brez tek tjetri.

Ndekombetarizimi i shoqërisë Suedeze imponon kërkesa të larta për aftësitë e njerezve për të jetuar dhe kuptuar vlerat në diversitetin kulturor. Parashkollori është një vend takimi shoqëror dhe kulturor, i cili mund ta përforcojë këtë dhe të përgatisë femijet për jetën në një komunitet që po nderkombetarizohet në rritje.

Ndergjegjesimi për trashëgimninë e tyre kulturore dhe pjesëmarrja në kulturën e të tjerëve do të kontribuojë në aftësinë e femijeve për të kuptuar dhe përshatur me kushtet rrethuese dhe vlerat e të tjerëve. Parashkollori mund të ndihmojë për të siguruar që femijet nga minoritetet kombëtare dhe femije me prejardhje të huaja të kenë mbështetje për zhvillimin e pranimet të dy kulturave.

Parashkollori duhet të sigurojë për femijet një mjedis të sigurt, që të paraqesë sfida për femijet dhe t'i nxite ata për lojë dhe veprimtari. Ai duhet t'i frymëzojë femijet për të eksploruar botën që i rrethon. Femijet në ciklin parashkollor duhet të jenë në kontakt me të rriturit të cilët shikojnë potencialin e mundshëm tek çdo femije individ dhe përfshijnë vetveten e tyre në bashkëveprim si me femijen individual dhe me grupin e femijeve në teresi.

Aftësia për të komunikuar, mesuar dhe aftësia për të bashkëvepruar janë të domosdoshme në një shoqëri që karakterizohet nga një fluks i madh informacioni dhe shpejtësi e vrullshme ndryshimi. Parashkollori duhet të sigurojë një bazë që femijet në të ardhmen të mund të përvetësojnë dije dhe aftësi të cilat përbejnë strukturën e përgjithshme që u nevojitet të gjithëve në shoqëri.

Femijet duhet të kenë mundësi të zhvillojnë aftësinë e tyre për të vezhguar dhe reflektuar. Parashkollori duhet të jetë një mjedis i gjallë shoqëror dhe kulturor që nxit femijet për marrjen e iniciativave dhe zhvillimin e aftësive të tyre shoqërore dhe komunikuese. Femijet duhet gjithashtu të kenë mundësinë për të eksploruar mbi çështjet e tyre me shumë hollësi dhe të kërkojnë përgjigjet dhe zgjidhjet e tyre. Loja është e rëndësishme për zhvillimin dhe të mesuarin e femijes. Përdorimi i vetëdijshëm i lojës për të nxitur zhvillimin dhe të mesuarin e çdo femije duhet të jetë një veprimtari e gjithëpranishme në ciklin parashkollor. Loja dhe kënaqësia e të mesuarit në të gjitha format e saj nxit imagjinatën, të kuptuarin, komunikimin dhe aftësinë për të menduar në mënyrë simbolike ashtu si edhe aftësinë për të bashkëpunuar dhe zgjidhur problemet. Përmes lojrave krijuese dhe imagjinare, femijet do të kenë mundësi të shprehin dhe të punojnë përmes eksperiencave dhe ndjenjave të tyre.

Parashkollori duhet të nxite të mesuarin, i cili presupozon diskutim aktiv në ekip pune për përmbajtjen e asaj që përben të mesuarin dhe dijen.

Dija është një koncept kompleks, i cili mund të shprehet në formë të ndryshme - si fakte, të kuptuarit, aftësi, familjaritet dhe eksperiencë – të gjitha nga të cilat presupozojnë njëra tjetren dhe bashkëveprojnë me njëra tjetren. Pikenisja për parashkollorin është

eksperiencia qe femijet tashme kane fituar, interesat e tyre, motivimi dhe detyrimi per te fituar dije.

Femijet kerkojne per dije dhe i zhvillojne ato permes lojes, bashkeveprimit shoqeror, eksplorimit dhe krijimtarise, ashtu si edhe permes vezhgimeve, diskutimit dhe reflektimit. Metoda per te punuar me teme te orientuar mund te zgjeroje dhe te pasuroje te mesuarin nga femija.

Te mesuarit duhet te zbatohet jo vetem ne bashkeveprimin midis te rriturve dhe femijeve por edhe ne ate qe femijet mesojne nga njeri tjetri. Grupi i femijeve duhet te konsiderohet si nje pjese e rendesishme dhe aktive ne zhvillimin e te mesuarit. Parashkollori duhet t'u jape femijeve mbeshtetje per te zhvilluar nje pamje pozitive te vetvetes si individe qe mesojne dhe krijojne. Ata duhet te mbeshteten ne zhvillimin e besimit ne aftesite e tyre per te menduar per vetveten, per te vepruar, per te levizur dhe mesuar d.m.th. per t'u zhvilluar nga prespektiva te ndryshme te tilla si intelektuale, gjuhesore, etike, praktike, ndjesore dhe estetike.

Femijet duhet te kene nxitje dhe drejtim nga te rriturit me qellim qe te rrisin aftesine e tyre dhe te pervetesojne dije te reja dhe intuitede permes aktivitetit te tyre. Kjo metode presupozon qe te dyja format e ndryshme te gjuhes dhe dijeve ashtu si dhe menytrat e ndryshme te mesuarit vihen ne balance dhe formojne nje te tere. Gjuhe dhe te mesuarit jane te lidhura pazgjidhshmerisht sebashku, ashtu si gjuha dhe zhvillimi i nje identiteti personal. Parashkollori duhet te theksoje me force zhvillimin gjuhesor te cdo femije dhe te nxitte dhe perfitoje nga kurioziteti i femijes dhe interesi ne gjuhen e shkruar.

Parashkollori duhet te ndihmoje per te siguruar qe femijet me gjuhe amtare tjetere nga Suedishtja, te kene mundesi te zhvillojne si gjuhen e tyre suedeze ashtu dhe gjuhen e tyre amtare.

Krijimi dhe komunikimi nepermjet formave te ndryshme te shprehjes, te tilla si pikturat, kenga dhe muzika, drama, ritmi, vallezi dhe levizjet, ashtu si edhe gjuha e folur dhe e shkruar perbejne te dyja - kontekstin dhe metoden qe duhet te perdoret nga parashkollori ne nxitjen e zhvillimit dhe te mesuarit prej femijes. Kjo perfshin gjithashtu te ndertuarin, projektimin, dhe perdorimin e materialeve dhe teknologjive te ndryshme. Multimedia dhe teknologjia informacionit mund te perdoren nga parashkollori ne zhvillimin dhe zbatimin e proceseve krijuese.

Parashkollori duhet te vere theksin ne ceshtje qe kane te bejne me mjedisin dhe konservimin e natyres. Nje metode ekologjike dhe besim pozitiv ne te ardhmen duhet te tipizojte veprimtarite e parashkollorit. Parashkollori duhet te kontribuojte ne sigurimin qe femija te pervetesojte nje qendrim perkujdeses ndaj natyres dhe mjedisit dhe te kuptojte se ata jane pjese e procesit te riciklimit te natyres. Parashkollori duhet te ndihmoje femijet te kuptojne se realiteti i perditshem dhe puna mund te organizohen ne menyre qe ato te kontribuojne ne nje mjedis me te mire, si tani dhe ne te ardhmen.

Parashkollori duhet t'i siguroje femijet me nje ritem dhe mjedis te perditshem te balancuar mire lidhur me moshen e tyre dhe kohen qe harxhojne ne institucionin parashkollor. Balanca duhet te arrihet midis kujdesit dhe pushimit ashtu si dhe me veprimtarite e tjera.

Femijet duhet te jene te afte te shkembejne dhe ndryshojne aktivitetet gjate dites.

Aktivitetet e tyre duhet te sigurojne hapesine per planet e vete femijes, imagjinen dhe krijimtarine ne loje dhe te mesurit si brenda dhe jashte institucionit parashkollor. Koha e

harxhuar ne veprimtari jashte (ne terren) duhet te siguroje mundesi per loje dhe aktivite te tjera si ne mjedis te planifikuar ashtu dhe ne mjedis natyror.

2. Objektiva dhe udhezime

Objektivat specifikojne orientimin e veprimtarise te parashkollorit dhe ne kete menyre objektivat e desheruara cilesore ne ciklin parashkollor.

Udhezimet per stafin e parashkollorit jo vetem percaktojne pergjegjesine e te gjithëve qe punojne ne ciklin parashkollor por gjithashtu pergjegjesine qe ka stafi pedagogjik ne sigurimin qe veprimtaria te drejtohet drejt objektivave te kurrikules.

2.1 NORMA DHE VLERA

Parashkollori duhet te influencoje aktivisht dhe ne menyre te ndergjegjshme dhe te nxitë femijet ne zhvillimin e te kuptuarit prej tyre dhe pranimit te vlerave te perbashketa demokratike te shoqerise tone.

Objektiva drejt te cileve duhet synuar

Parashkollori duhet te perpiqet te siguroje qe çdo femije te zhvilloje

- Çiltersine (te qenet i hapur), respektin, solidaritetin dhe pergjegjesine,
- Aftesine per te marre parasysh dhe per t'u pajtuar me situaten e te tjereve si edhe deshiren per te ndihmuar te tjeret,
- Aftesine e tyre per te zbuluar, reflektuar dhe percaktuar pozicionin e tyre ne dilema etike te ndryshme dhe pyetje thelbesore te jetes ne realitetin e perditshem,
- Te kuptuarin qe te gjithë personat kane vlera te barabarta te pavarurua nga prejardhja gjinia, prejardhja shoqerore apo etnike.
- Respekti per te gjitha format e jetes ashtu si dhe kujdesi per mjedisin rrethues .

Udhezime

Te gjithë qe punojne per parshkollorin duhet

- Te tregojne respekt per individin dhe te ndihmojne ne krijimin e nje klime demokratike ne ciklin parashkollor, ku mund te zhvillohet ndjenja e perkatesise dhe pergjegjesise dhe ku femijet kane mundesi te tregojne solidaritet dhe te nxitin bashkeveprimin midis tyre dhe t'i ndihmojne femijet te zgjidhin konflikte ashtu si edhe te shtjellojne keqkuptimet, kompromisin dhe respektin per njeri tjetrin.

Stafi pedagogjik

- Eshte i pergjegjshem per te siguruar qe nevojat e çdo femije te respektohen dhe plotesohen dhe qe ata te jene te afte te perjetojne dhe provojne vlerat e tyre unike,
- Eshte i pergjegjshem per te siguruar qe parashkollori zbaton metoda pune demokratike ne te cilat femijet marrin pjese aktivisht,
- Duhet te theksojne dhe ballafaqohen me probleme te perfshira ne dilema etike dhe pyetje per jeten,

- Duhet t'i ndergjegjesojne femijet se njerzit mund te kene qendrimet dhe vlera te ndryshme qe percaktojne pikpamjet dhe veprimet e tyre,
- Duhet te jene te pergjegjshem per zhvillimin e normave per punen dhe pjesmarrjen ne aktivite per grupin e femijeve
- Duhet te bashkepunojne me familjen lidhur me rritjen e femijeve dhe te diskutojne me prinderit rregullat dhe qendrimet e parashkollorit.

2.2 ZHVILLIMI DHE TE MESUARIT

Parashkollori duhet te karakterizohet nga nje metode pedagogjike, ku kujdesi, rritja/edukimi dhe te mesuarit formojne sebashku nje teresi koherente. Veprimtari pedagogjike duhet te kryhen ne menyre qe te nxitin dhe te sfidojne te mesuarin dhe zhvillimin e femijes. Mjedisi mesimor duhet te jete i hapur, i pasur ne permbajtje dhe terheqes. Aktivitetet duhet te nxitin lojen, krijimtarine dhe kenaqesine per te mesuarit ashtu si edhe perqendrimin dhe forcimin e interesit te femijes per te mesuarin dhe pervetesimin e eksperiencave te reja, dijeve dhe aftesive.

Aktivitetet duhet te kontribuojne qe femijet te zhvillojne te kuptuarin e vetvetes dhe botes qe i rrethon. Nje ndjenje eksplorimi, kurioziteti dhe deshire per te mesuar duhet te formoje bazen per veprimtari pedagogjike. Keto duhet te bazohen ne eksperiencat e femijes, ne interesat, nevojat dhe pikpamjet. Rrjedhja e mendimeve dhe ideve te femijeve duhet te perdoret per te krijuar larmi ne te mesuar.

Objektiva drejt te cilave duhet synuar

Parashkollori duhet te siguroje qe femijet

- Te zhvillojne identitetin e tyre dhe te ndihen te sigurt ne vetvete,
- Te zhvillojne njeherazi kuriozitetin e tyre dhe kenaqesine e tyre si dhe aftesine per te luajtur dhe mesuar,
- Te zhvillojne vet-autonomi dhe besim ne aftesite e tyre,
- Te ndiejne sensin e pjesmarrjes ne kulturen e tyre dhe te zhvillojne ndjesi dhe respekt per kultura te tjera,
- Te zhvillojne aftesine e tyre per te degjuar, treguar, reflektuar dhe shprehur pikpamjet e tyre,
- Te zhvillojne aftesine e tyre per te funksionuar individualisht dhe ne grup, per te trajtuar konflikte dhe per te kuptuar te drejtat dhe detyrimet ashtu si edhe te kene pergjegjesi per rregulla te perbashketa,
- Te zhvillojne shprehite e tyre motore, aftesite per te koordinuar, ndergjegjesimin per trupin e tyre, si dhe te kuptuarin e rendesise te ruajtjes te shendetit dhe mireqenies te tyre,
- Te pervetesojne dhe te jene te afte te dallojne ndryshimet ne kuptimet e koncepteve, te verejne nderlidhjet dhe te zbulojne menyra te reja te te kuptuarit te botes qe i rrethon,
- Te zhvillojne nje gjuhe te folur te pasur dhe te ndryshme dhe aftesine per te komunikuar me te tjeret dhe per te shprehur mendimet e tyre,

- Te zhvillojne fjalorin dhe konceptet e tyre, aftesine per te luajtur me fjalet, interesin ne gjuhen e shkruar dhe te kuptuarit e simboleve ashtu si edhe funksionet e tyre komunikuese,
- Te zhvillojne aftesi krijuese dhe aftesi per te transmetuar mendime dhe eksperienca ne forma te ndryshme te shprehjes, te tilla si, loja, pikturat, kenga dhe muzika, kercimi dhe drama,
- Te zhvillojne aftesine e tyre per te ndertuar, krijuar dhe projektuar duke perdorur materiale dhe teknika te ndryshme,
- Te zhvillojne aftesine per te zbuluar dhe perdorur matematiken ne kontekste dhe situata te kuptimshme,
- Te zhvillojne aftesine per te zbuluar dhe perdorur matematiken ne kontekste dhe situata te kuptimshme,
- Te zhvillojne vleresimin e tyre per karakteristikat baze te konceptit te numrit, madhesis dhe formes ashtu si edhe aftesine per te orientuar vetveten ne kohe dhe hapesire
- Te zhvillojne te kuptuarin e perfshirjes se tyre ne proceset e natyres dhe ne fenomene te thjeshta shkencore te tilla si njohuri mbi bimet dhe kafshet.

Udhezime

Te gjithë që punojnë në parshkollorin duhet

- Te bashkepunojnë për të siguruar një mjedis të mirë për zhvillimin, lojën dhe të mesuarin, dhe t'i kushtojnë vëmendje të veçantë dhe t'i ndihmojnë këta fëmijë të cilët për arsye të ndryshme kanë nevojë për mbështetje në zhvillimin e tyre,.

Ekipi pedagogjik duhet

- Te jete i pergjegjshem per te siguruar qe puna ne grupin e femijeve kryhet ne menyre qe femijet:
 - te zhvillohen ne perputhje me kapacitetin e tyre dhe ne te njejten kohe te nxiten ne perdorimin dhe zhvillimin e gjithë aftesive te tyre,
 - te provojnë ndjenjen e kenaqesise dhe logjikes per te mesuar çfare eshte e re,
 - te perballen me sfida te reja qe nxisin kenaqesine ne te mesuarin e shprehive, eksperiencave dhe njohurive te reja,
 - te kene mbeshtetje dhe nxitje ne gjuhen e tyre dhe zhvillim komunikativ,
 - te kene mbeshtetje dhe nxitje ne zhvillimin e aftesive motore dhe
 - te kene kujdesin cilesor dhe nje ritëm të mirë-balancuar të perditshem,
- te kene parasysh zellin e femijeve, deshiren dhe kenaqesine e tyre per te mesuar dhe te forcojne besimin ne aftesite e tyre,
- te sigurojne nxitje dhe mbeshtetje te veçante per ata femije qe perjetojne veshtiresi te llojeve te ndryshme,
- te nxitin kuriozitetin e femijeve dhe te kuptuarin qe ne fillim prej tyre te gjuhes se shkruar dhe matematikes,

- t'i japin femijeve mundesi per t'u njohur me mjedisin e tyre dhe funksione qe jane te rendesishme per jeten e tyre te perditshme, ashtu si edhe te njihen me kulturen e zones te tyre.

2.3 Ndikimi tek femija

Parashkollori siguron bazat qe femijet te kuptojne se çfare eshte demokracia. Zhvillimi shoqeror i femijes presupozon qe ne lidhje me kapacitetin e tyre, ata duhet te jene te pergjegjshem per veprimet e tyre dhe per mjedisin e parashkollorit. Nevojat dhe interesat qe femijet shprehin vete ne menyra te ndryshme duhet te sigurojne bazen per formimin e mjedisit dhe planifikimin e veprimtarive pedagogjike.

Objektiva drejt te cileve duhet synuar

Parashkollori duhet te perpiqet te siguroje qe femijet

- Te zhvillojne aftesine per te shprehur mendimet dhe pikpamjet e tyre dhe ne kete menyre te kene mundesi te ndikojne ne situatat e tyre,
- Te zhvillojne aftesine e tyre per te pranuar pergjegjesi per veprimet e tyre dhe per mjedisin e parashkollorit dhe,
- Te zhvillojne aftesine per te kuptuar dhe vepruar ne perputhje me parime demokratike te pjesmarrjes ne lloje te ndryshme te bashkepunimit dhe vendim-marrjes.

Udhezime

Te gjitha qe punojne ne institucionin parashkollor duhet

- Te punojne per te siguruar qe çdo femije te zhvilloje aftesine dhe deshiren per te marre pergjegjesi per te ushtruar influence ne parashkollorin dhe,
- Te punoje per te siguruar qe opinionet dhe pikpamjet e çdo femije te respektohen.

Ekipi pedagogjik duhet

- Te perfitoje nga aftesia e femijeve dhe te deshiroje te marre pergjegjesi me te madhe per vete dhe per pjesmarrje ne grupin e femijeve,
- Te sigurohet qe te gjitha femijet kane mundesi mbi baza te rritjes se aftesive te tyre per te influencuar ne permbajtjen e veprimtarive, metodave te punes dhe te marrin pjese ne vleresimin e aktiviteteteve,
- Te punojne per te siguruar qe si vajzat dhe djemte kane nje mase te barabarte influence dhe hapesire per pjesmarrje ne aktivitete,
- te pergatisin femijet per te marre pjese dhe ne ndarjen e pergjegjesive, te drejtave dhe detyrimeve ne nje shoqeri demokratike.

2.4 PARASHKOLLORI DHE FAMILJA

Prinderit apo kujdestaret jane te pergjegjshem per rritjen dhe zhvillimin e femijes se tyre. Parashkollori duhet te plotesoje familjen duke krijuar parakushtet me te mira te mundshme per te siguruar qe zhvillimi i çdo femije te jete i pasur dhe i larmishem. Puna e parashkollorit me femijen duhet te kryhet ne bashkepunim te ngushte dhe konfidencial me familjen. Prinderit duhet te kene mundesi brenda struktures te objektivave kombetare te perfshihen dhe te ndikojne ne aktivitetet e parashkollorit. Nje para-kusht per femijet dhe prinderit qe te kene mundesi te ushtrojne ndikimin e tyre, eshte qe parashkollori te jete i qarte per synimet dhe permbajtjen e punes se tij.

Udhezime

Te gjitha qe punojne ne insitucionin parashkollor duhet

- Te tregojne respekt per prinderit dhe te ndjehen te pergjegjshem per zhvillimin e maredhenieve te mira midis stafit te parashkollorit dhe familjeve te femijeve.

Ekipi pedagogjik duhet

- Te jete i pergjegjshem sebashku me prinderit per te siguruar qe femijet te marrin nje informacion te mire prezantues ne parashkollorin,
- Te mbajne nje dialog te vazhdueshem me prinderit per mireqenien e femijes, zhvillimin dhe te mesuarin, si brenda dhe jashte parashkollorit, krahas zhvillimit te dialogut personal,
- Te mundesojne prinderit te ushtrojne ndikimin e tyre mbi si mund te konkretizohen objektivat ne planifikimin e veprimtarive pedagogjike,
- Te kene ne konsiderate pikpamjet e prinderve kur planifikojne dhe kryejne aktivite dhe
- Te sigurohen qe prinderit jane te perfshire ne vleresimin e aktiviteve.

2.5 Bashkepunimi midis klases parashkollore, shkolles dhe qendres te kohes – te lire

Me qellim qe te mbeshtese zhvillimin e gjithanshem te femijeve, shkolla duhet te perpiqet te vendose bashkepunim te mire pune me parashkollorin dhe qendrave te kohes se lire me qellim qe te mbeshtese zhvillimin e pergjithshem te femijes dhe te mesuarin per te ardhmen. Bashkepunimi duhet te bazohet ne objektiva kombetare dhe lokale dhe ne udhezime te zbatueshme ne veprimtari te ndryshme.

Kur vjen koha qe femija te transferohet ne aktivite te reja, parashkollori ka detyren e veçante te gjetjes se modeleve per te plotesuar periudhen parashkollore. Ne kalimin ne aktivite te reja, vemendje e veçante duhet ti kushtohet atyre femijeve qe kane nevojë per mbeshtetje te veçante.

Udhezime

Ekipi pedagogjik duhet

- Te shkembeje njohuri dhe eksperienca me stafin e klases parashkollore, shkollen dhe qendren e kohes se lire dhe te bashkepunoje me ato, ashtu si dhe
- Sebashku me stafin ne klases parashkollore, shkollen dhe qendren e kohes se lire , t'i kushtoje vemendje nevojave te çdo femije per te patur nxitje dhe mbeshtetje.

Perkthyer nga: Adriana Bisha

Translation was enabled by U.S. Democracy Commission Grant